



Pranuar / Dorezuar Primiten/Protolito Received/Deliverty	17-12-2021	1	viti god year
Organ /Nesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSH/CK	6215/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.742/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari -anëtarë,si dhe Zyle Millaku Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësin e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin A.nr.3027/19 të datës 15.11.2021,të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.742/2019 të datës 02.12.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rr."Brigada153", pa nr.Hajvali në Prishtinë, kundër organit të punësimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës /Gjykata Supreme, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 17.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e pa lejuar ankesa me numër A.nr.742/2019, e datës 02.12.2019 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës në pozitë: "Zyrtar i prokurimit", në Gjykatën Supreme, sipas Vendimit mbi ricaktimin nr.03/2153 të datës 29.12.2015 , bazuar në Akt emërimit e datës 31.12.2012. Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datë 23.08.2019 , ka nxjerrë Vendimin me numër 03/662 për përfundimin e marrëdhënies së punës me rastin e arritjes së moshës së pensionimit për ankuesin, duke i njohur të drejten e një page, të njëhershme në vlerën e pagës së fundit.

Ankuesi kundër Vendimit me numër 03/662 të datës 23.08.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 02.12.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të regjistruar më numër protokollit 5641/2019, me pretendimin ankimor të mos pagesës së dy (2) pagave përcjellëse dhe tri (3) pagave jubilarë me rastin e pensionimit, duke u bazuar në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të vitit 2015.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 16.12.2019, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Këshilli Gjyqësor i Kosovës /Gjykata Supreme. Me datë 19.12.2019 Këshilli i

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka pranuar përgjigjën në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura .

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 02.12.2019 e parashtruar nga ankuesi me numër protokoll 5641/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi nr.03/2153 i datës 29.12.2015 ; Akt emërimit e datë 31.12.2012; Vendim me numër 03/662 i datës 23.08.2019 i Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Njoftimi nr. 03/972 i datës 19.11.2019; Aktgjykim i datës 26.09.2019 me numër A.nr.1334/2017 i Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigje në ankesë e datës 19.12.2019 nga Gjykata Supreme; Formulari për Urdhër obligimi për pagesë i datës 16.10.2019, Lista e pagës e muajit Gusht 2019 .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe konstatoi se ankesa e ankuesit **është e pajtuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi me datë 02.12.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor të mos pagesës së dy (2) pagave përcjellëse dhe tri (3) pagave jubilarë me rastin e pensionimit, duke u bazuar në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të vitit 2015 , duke potencuar faktin përmes kërkesës së datës 07.11.2019 se në llogarinë e tij bankare nuk është bërë pagesa e dy (3) pagave përcjellëse dhe tri (3) pagave jubilarë me rastin e pensionimit nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke kërkuar njëkohësisht pagesën e këtyre pagave.

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesi me datë 23.09.2019 e ka pranuar vendimin me numër 03/662 të datës 23.08.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa në këtë periudhë ka qenë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dhe se veprimet procedurale duke përfshi edhe ankesën do të duhej të bazoheshin në dispozitat e këtij ligji dhe dispozitave tjera ligjore që rregullojnë këtë çështje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, duke vërtetuar faktin se ankuesi me datë 23.09.2019 ka pranuar vendimin e datës 23.08.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, (të konfirmuar sipas fletë kthesës), dhe se me datë 02.12.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi këtë bazë ankuesi ka qenë i obliguar që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve ,sipas dispozitës së nenit 127 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”** ,të parashtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në pajtim me dispozitën e nenit 24 paragrafi 3 të ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i cili ka përcaktuar se: **“Nëpunësit civil kanë të drejtë të paraqesin ankesë drejtpërdrejtë në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim, që i cenohet e drejta”**.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas konstatimit se ankesa e ankuesit është parashtruara jashtë afatit ligjor, siç e përcakton neni 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka vlerësuar se nuk mund të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve të ankueses, por ka vendosur që ta hedhë poshtë si të palejuar ankesën e ankuesit të datës 02.12.2019 me numër A.nr.742/2019 të protokolluar 5641/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.742/2019, data 17.12.2021.

Zyle Milaku-Gojnovci

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Gjykatës Supreme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

